



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Ref: 07/04/01-279 /2017

Njësia Organizative: Drejtoria për Buxhet dhe Financa- AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarte lidhur me buxhetin, financat e drejtorisë.

Detyrat kryesore:

1. Udhëheqë drejtorinë dhe cakton objektivat e tij në pajtim me strategjinë dhe objektivat e institucionit dhe harton plane të punës vjetore të detajuara për të përmbushur këto objektiva 20%
2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit 15%;
3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë 10%;
4. Siguron, dhe koordinon planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit në përputhje me objektivat e institucionit 15%;
5. Siguron që shpenzimet financiare të jenë në përputhje me planifikimet, rregullat dhe procedurat buxhetore si dhe përgatit raporte periodike mbi shpenzimet buxhetore në bazë të LMFPP-së 10%;
6. Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron që kontrolli i brendshëm financiar është bazuar në parimet e llogaridhënies 15%;
7. Siguron bashkëpunimin dhe koordinimin me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm në kryerjen e aduditimeve dhe përgatitjen e pasqyrave buxhetore financiare 10%;
8. Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

1. Njohuri dhe përvojë në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit
2. Diploma Universitare apo te avansuar në fushen e Ekonomisë, Financa, 6 vite përvojë pune profesionale, së paku 3 vite në pozita drejtuese;
3. Shkathesi të lartë në menaxhim, organizimi, caktim të objektivave dhe planifikim.
4. Njohuri të mira për mbikqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit.
5. Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit.
6. Fleksibilitet të lartë ndaj organizimit dhe mbikqyrjes së punës përfishir zgjedhjen e problemit.
7. Njohuri mbi punën dhe politiken e institucioneve publike në Kosovë.
8. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve : (Windowsin, World, Exel Access-in, dhe Microsoft Office).
9. Njohuri të gjuhës angleze.

Data e shpalljes së konkursit me: 06.09.2017

Data e mbylljes së konkursit me:20.09.2017

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranoen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 23 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.